

**STATUT**  
**I**  
**Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**"BLU Group" shpk,**



Ne respektim të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ndryshuar me ligjin 129/2014, dhe ligjit 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe bazuar në Aktin e Themelimit të Shoqërise:

1. **Arlind Xhoni**, i biri i Sulejmanit, i dtl. 02/03/1992, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Siri Kodra" nr 252, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtes i kartës identitetit me nr. 032581612.

i cili me çilesinë e "Ortakut Themelues", me vullnet të lire, të plote e të singërte, hartoi këtë Akt Themelimi të Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar, me emërtimin "**BLU Group**" shpk. i cili me çilesinë e "Ortakut Themelues", me vullnet të lire, të plote e të singërte, hartoi këtë Statut të Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar, me emërtimin "**BLU Group**" shpk.

## KREU I

### Neni 1 Krijimi

Shoqëria "**BLU Group**" shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

### Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "**BLU Group**" shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "një ortak", i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

### Neni 3 Selia

1. Shoqëria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën : Rr "Prokop Myzeqari", Nd.4, H.9, Ap.6, Njesia Administrative nr.9, 1016, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësimi, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

- A) Punime dhe shërbime në lartësi me kosh, riparim, ristrukturim banesash dhe fasadash. Prodhim shërbim mobileri, objekte arredimi. Transporte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Organizimin dhe zbatimin e fushave promovuese, eventeve dhe evenimenteve të çdo lloji, veprimtari marketingu, promovimi dhe distribucioni për të gjitha llojet e shërbimeve dhe mallrave për llogarë të vetat, ose në funksion të të tretëve. Këshillim profesional; konceptimi, organizimi dhe menaxhimi i reklamave të fushatave, eventeve, fushatave të marketingut, marrëdhënieve me publikun, spoteve publicitare, në fushën e design-it, publikimeve, reklamave dhe promovimit.
- B) Import-Eksport, produkte ushqimore, makineri industriale dhe ndërtimi, pajisje elektronike, automjete të reja dhe të përdorura, materiale bujqësore dhe ushqimore, fruta perime, pjesë këmbimi goma bateri. Punime druri dhe mobilje, duralumini metalike. Import-Eksport konfeksione, pajisje hidrosanitare, hidraulike, elektrike dhe kancelari. Tregtim të disinfektantëve e pesticideve dhe makineri mjekësore. Administrim dhe mirëmbajtje të ambienteve të jashtme si gjelbërim dhe pastrim i tyre. Import –Eksport si dhe tregti me shumicë e pakicë të pajisjeve mjekësore. Aktivitet në fushën e tregtimit të materialeve të pastrimit.
- C) Shpërndarje, shitje me shumicë dhe pakicë import-eksport të materialeve optike dhe instrumenteve optikë, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, aksesori të modës dhe këpucëve si dhe çdo veprimtari të lidhur me to. Kryerja e çdo lloji operacioni tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.
- D) Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

**KREU II**  
**KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.  
Kapitali i mesipër është nënshkruar dhe shlyer teresisht në të holla nga "Ortaku" i shoqërisë

**Arlind Xhoni**, është zotëues i 1 kuote me vlerë 100 000 leke, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tjerëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të rritet me vendim të ortakut të vetëm së cilësuar prej 100% të shoqërisë. Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë me emërimin nga gjykata kompetente e një eksperti të caktuar për kuantifikimin e këtyre kontributeve në përdorimin e shumicës së cilësuar të kompanisë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.


Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- f) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- g) shitblerjes;
- h) trashëgimisë;
- i) dhurimit;
- j) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie duke marrë gjithmonë aprovimin e Asamblese së Ortakut të Vetem.

### **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 9**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakut të Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të Vetem, vendos për çështje si :

- h) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- i) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- j) emërimin e shkarkimin i Likuiduesve dhe të Eksperti Kontabel të Rregjistruar;
- k) përcaktimin e shpërblimeve
- l) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- m) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakut të Vetem regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- g) investime;
- h) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Ortakut të Vetem, nga një person i tretë i paisur me autorizim .

Administratori nuk mund të veprojnë si përfaqësues i vetëm Ortakut.

Autorizimi mund të jepet vetëm në një mbledhje, dhe vlen edhe për takimet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10**

#### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është z. **Arlind Xhoni**.

Administratori i shoqërisë do të ushtrtojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asambleja e Ortakut të Vetem të



Shoqërise. Administrator i shoqërise mund të emerohet edhe një person i tretë jashtë ortakërise.

#### Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- h) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut të Vetem të Shoqërise;
- i) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- j) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- k) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- l) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- m) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- n) raportojë përpara Asamblesë së Ortakut të Vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Ortakut të Vetem të Shoqërise edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12 Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut të Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas



neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar

1. Administratori detyrohet

- f. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- g. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- h. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- i. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- j. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

5. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

6. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

7. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- f. i kthen ortakut kontributet;
- g. i paguan ortakut interesa apo dividendë;
- h. i shpërndan ortakut aktivet shoqërisë;
- i. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- j. jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.



Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 15 Ekspertet

Eksperti Kontabel i Rregjistruar ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise.

Ne perfundim të kontrollit Eksperti Kontabel i Rregjistruar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të rezervave ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut të shoqerise.

#### Neni 17 Prishja e shoqerise

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
  - a. kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
  - b. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - c. në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
  - d. në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"; i ndryshuar
  - e. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
  - f. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
  - g. për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakut te vetem.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". i ndryshuar
3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij

neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar

### Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

### Neni 19

#### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesit është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", i ndryshuar likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

### Neni 20

#### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të



Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar

#### Neni 21 Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

#### Neni 22 Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakut te Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve të ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare " ndryshuar me ligjin 129/2104.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasoje:
  - a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
  - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
  - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar pa kryerjen e likuidimit.

#### Neni 23 Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te tij në shoqëri aksionare  
Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

#### Neni 24 Baza Ligjore



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky Statut i shoqerise "**BLU Group**"shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakut themelues", ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

**ORTAKU I SHOQERISE**

**Arlind Xhoni**



12.09.2018

Notere Majlinda DEMOLLARI

Dhoma e Noterise Tirane

Rr"Vaso Pasha "

Tel Fax ++269948

Nr. 3211 Rep

Nr. Kol

1735



## VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 12.09.2019 ( dymije e nentembedhete) vertetoj nenshkrimin e **Shoqeria " Blu Group "shpk**, e perfaqesuar nga ortaku i vetem i saj Arlind Xhoni, i datelindjes 02.03.1992, lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin ID J20302071S i cili deklaroi se sa me siper eshte nenshkruar prej tij dhe une noterja Majlinda E. Demollari vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERE  
Majlinda E. Demollari  
NOT. 241606040A  
0682061560